

FM RAPID 180



PERSHKRIMI

Ngjitës me bazë çimento me tharje të shpejtë për ngjitjen e pllakave qeramike, gres, porcelan, etj.

KLASIFIKIMI I PRODUKTIT

FM 180 Rapid është klasifikuar si C2F sipas EN 12004, baza C çimento, 2 ngjitës me forcë ngjitëse të lartë, F tharje finale e shpejtë.

KARAKTERISTIKAT

- Për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm.
- Për zonat e thata dhe me lagështi.
- Përmirësim i parametrave të punës.
- Për fiksimin e pllakave qeramike, gres dhe porcelan.
- Për fiksimin e pllakave qeramike, gres dhe porcelan në sipërfaqe gipsi pasi është trajtuar me primer.

FUSHA E PËRDORIMIT

FM 180 Rapid përdoret për shtrimin e pllakave qeramike, gres dhe porcelan, pllaka të dimensioneve të ndryshme në sipërfaqe të ndryshme të tilla si: beton, veshje izoluese, çimento, suva, pllaka të vjetra, etj. Ky produkt është i përshtatshëm për brenda dhe jashtë. FM 180 Rapid gjithashtu mund të aplikohet në sipërfaqe të deformueshme si pllaka gipsi, druri, apo dyshe me ngrohje qendrore kur përfordhet me adetivin dw 17, adetiv që përmirëson parametrat teknike të ngjitës.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Forma:	Pluhur
Ngjyra:	Bardhe / Gri
Sasia e ujit per hidratim:	7 l/25 kg bag
Temperatura e aplikimit:	nga +50C deri ne +350C
Spesori aplikimit:	deri ne 30 mm
Koha e punimit:	te pakten 5 ore
Koha e punueshmerise:	35 min
Rreshkitshmeria:	0,2 mm
Mbushja e fugave ne mure:	pas 8 oresh
Mbushja e fugave ne dyshe:	pas 24 oresh
Forca ngjitese pas 28 ditesh ne:	
• Kushte normale:	≥ 1,73 N/mm2
• Veprimin e nxehtesisene +70°C:	≥ 1,63 N/mm2
• Zhytjen ne uje:	≥ 1,59 N/mm2
• Ciklet ngrirje shkrijë:	≥ 1,56 N/mm2
Rezistenca temperatuore:	nga -30C ne +90C

PREGATITJE E APLIKIMIT

Suportet tradicionale me bazë çimento duhet të kenë një kohë maturimi të mjaftueshme prej (28 ditë në temperaturë 230c dhe u.R 40%). Suportet duhet të jenë të sheshta dhe të qëndrueshme në funksion të qëllimit të përdorimit. Suporti ku do të aplikohet produkti duhet të jetë i pastër, pa lëndë të huaja të tilla si: bojra, vajra, verniqe, material anti-ngjitëse. Pastrimi bëhet në mënyrë mekanike ose manuale. Suvatë përpara aplikimit të produktit duhet të kenë një maturim të paktën 1 javë për 1 cm trashësi. Suportet duhet të jenë mekanikisht të qëndrueshëm në funksion të qëllimit të përdorimit. Sipërfaqja e suportit ku do të aplikohet produkti duhet të jetë e pastër nga çdo lloj lënde e huaj.

APLIKIMI

Për një aplikim sa më të mirë të produktit si dhe për të përfutur një shpërndarje të mirë dhe uniforme në të gjithë sipërfaqen, rekomandohet që fillimisht shtrimi i produktit mbi suport të bëhet me pjesën e drejtë të mallës, e më pas me pjesën e dhëmbëzuar. Produkti duhet të aplikohet me një mallë të përshtatshme në varësi të tipit dhe përmasave të pllakës. Rekomandohet që mbas vendosjes së pllakës, të ushtrohet presion mbi të në mënyrë që pjesa e pasme të laget plotësisht. Në kushte të veçanta si: temperaturat e larta apo erërat e forta, dielli apo substrate me një absorbim të lartë të ujit që ndikojnë negativisht në performancën e produktit madje mund të ulin në mënyrë të ndjeshme kohën e hapjes dhe të korrektimit, rekomandohet që suportit të spërkatet me ujë përpara aplikimit të ngjitësit ose të trajtohet me astarin dw primer. Gjithsesi në çdo rast është e rëndësishme që përpara shtrimit të pllakës të kontrollohet nëse ngjitësi ka formuar cipë. Në një rast të tillë duhet të bëhet një rishpërndarje e ngjitësit për të riaktivizuar forcën ngjitëse të tij. Duhet shmangur derdhja e ujit mbi ngjitësin që ka krijuar cipë (është ngurtësuar) sepse në një rast të tillë formohet një shtresë anti-ngjitëse. Në rastin e veshjeve dhe dysHEMEVE në ambiente të jashtme sidomos në rastet kur pjesa e pasme e pllakave është me reliev këshillohet që ngjitësi të përhapet edhe në pjesën e pasme të pllakës edhe në suport në mënyrë që të mos krijohen zgavra (kavitete) në të cilat mund të penetrojë uji apo të formohet lagështi, të cilat mund të shkaktojnë më pas shqitjen ose edhe thyerjen e pllakave.

RUAJTJA

12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në paketimin e tij origjinal dhe të mbyllur, në zona të mbrojtura nga dielli dhe ngricat.

KONSUMI

4- 5 kg/m²

PAKETIMI

FM 180 Rapid është e mbushur në thasë letre prej 25 kg.

